



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DIBËR  
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

VENDIMI 117 Date 15.09.2020

**“Për Përdorimin e Fondit Rezervë, nga Granti & Të Ardhurat”**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, duke u mbështetur në ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe ligjit nr.88/2019 datë 18.02.2019 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2020”, i miratuar me vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër nr.140 datë 26.12.2019, i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Dibër me shkresën , nr.16/1 prot. datë 17.01.2020, kërkojmë që të përdoret fondi rezerve për rast fatkeqesie shpenzime funerale sipas kërkesës së ardhur nga ana e familjarëve si familje në nevojë me kërkesën nr.2581 datë 24.07.2020: Këshilli Bashkiak Dibër në mbledhjen e tij, datë 15.09.2020 me 19 vota pro 0 vota kundër.

**VENDOSI:**

1. Nga fondi rezerve, nga Granti & te Ardhurat janë planifikuar në buxhetin e Bashkisë Dibër vlera 20,277,200 lekë, të përdorura janë në vlerën 11,251,582 lekë, mbetën për tu përdorur 9,025,618 lekë, t’i jepet ndihmë për rast shpenzime funerale: Hasime Mehmet Zhavelli ( e ndjera) shuma prej 65.000 (gjashtëdhjetë e pesëmijë) lekë.
2. Pakësohet fondi rezervë **1810** në vlerën 65.000 (gjashtëdhjetë e pesëmijë) lekë dhe shtohet struktura **1110** llogaria **604** ne vlerën 65.000 (gjashtëdhjetë e pesëmijë) lekë.
3. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Ekonomike (Sektori i Financës) pranë Bashkisë Dibër.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit dhe shprehjes për bazueshmëri ligjore nga institucioni i Prefektit të Qarkut Dibër.

**KRYETAR KËSHILLI**

**SOKOL SAVA**

